

KËRKESË

Tiranë, më 09.09.2019

DREJTUAR : KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PËR DIJENI : **PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**
SH.T.Z ILIR META

AVOKATIT TË POPULLIT
ZNJ ERINDA BALLANCA

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Unë Prof. Dr. Zhaklina Peto, kam aplikuar në 2 (dy) vakancat e shpallura nga Presidenti i Republikës më 07.02.2018 për anëtare të Gjykatës Kushtetuese, si një juriste që mbart mbi vete 24 vite karrierrë si pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë.

Kam hyrë në këtë garë me sigurinë se plotësoja të gjitha kriteret dhe nuk kisha asnjë pengesë ligjore për të qënë pjesë e këtij procesi.

Me Vendimet Nr. 108 dhe 109, Dt. 02.08.2019, jam ndaluar të kandidoj për vendet vakante në GJ.K, në bazë të Nenit 235, pika 4 të Ligjit 115/2016.

Vendimet e KED për ndalimin e kandidimit janë ankimuar nga ana ime në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila me Vendimin Nr. 201, Dt 22.08.2019 ka vendosur: *“Shfuqizimin e vendimeve nr. 108 dhe nr.109 dt 02.08.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”*.

TË NDERUAR ANËTARË TË KED,

Me rifillimin e procedurës së verifikimit që po realizohet nga ana juaj, pas vendimit Nr 201, Dt 22.08.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit, vlerësoj dhe dua t’ju sjell në vëmendje një fakt të rëndësishëm që lidhet me pengesën ligjore për paanshmëri në këtë proces.

Në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 i ndryshuar *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, Kreun IV *“Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave”*, Neni 37/pika 1 parshikohet se:

“1. Zyrtari, në ushtrimin e funksioneve të tij, paraprkisht, sipas rrethanës, nevojës, në mënyrë të shkallëzuar ose në proporcion me rëndësinë e situatës, mënjanon dhe zgjidh vetë çdo situatë të konfliktit të interesit, të çdo forme qoftë ajo, duke përdorur, sipas rastit dhe përshtatshmërisë, një apo disa nga mënyrat e mëposhtme:

b) duke u vetëpërkjashtuar paraprkisht nga procesi konkret i vendimmarrjes, me përjashtim të rasteve kur është e pamundur delegimi i kompetencave të zyrtarit te një zyrtar tjetër, për shkak të ligjit apo për shkak të situatës ose në rastet e organit kolegjal, duke mos marrë pjesë në diskutimin dhe votimin e çështjes në konflikt.”

Referuar zbatimit të kësaj dispozite ligjore unë isha në pritje që KED të më informonte për zgjidhjen e kësaj situatë, duke e konsideruar të pa mundur zhvillimin e një vendimarrje në lidhje me kandidaturën time, për faktin se nëpërmjet Vendimeve Nr. 108 dhe Nr. 109 të datës 02.08.2019, ju si anëtarë të KED, jeni shprehur një herë për ndalimin tim në këtë pozicion, fakt që ndikon formimin e bindjes suaj ndryshe në këtë proces rivlerësimi.

Dëshiroj t'ju sjell në vëmendje se në Ligjin Nnr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” Kreu II “Përbërja e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, Neni 220 në pikën 3 të tij parashikohet se:

Në rast pamundësie ose të konfliktit të interesit anëtarët zëvendësohen nga anëtarët zëvendësues.
Duke ju referuar Kodit të Procedurës Administrative i cili përbën bazën ligjore të veprimtarisë së KED-së dhe konkretisht pjesës së tretë të këtij Kodi: “GARANTIMI I PAANSHMËRISË SË ADMINISTRATËS PUBLIKE”

Në nenin 30 “Pengesat ligjore”, parashikohet se:

Nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrës, në rastet kur:

“.... c) nëpunësi publik, ose anëtari i organit kolegjal ose edhe personat e parashikuar në shkronjën “b”, të këtij neni, kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në një çështje objektivisht të njëjtë dhe me të njëjtat rrethana ligjore me çështjen në shqyrtim;
e) çështja në shqyrtim është një ankim kundër një vendimi të marrë nga nëpunësi publik ose nga personat e parashikuar në shkronjën “b” të këtij neni:”

Në këto kushte, është e qartë se me vendimarrjen tuaj të mëparshme, dhe shfuqizimin e saj nga Gjykata Administrative e Apelit, KED nuk gëzon më besimin se do të realizojë një proces objektiv të pandikuar, pasi vlerësimi i provave të administruara prej tij, është bërë tashmë një herë nga ju.

Një tjetër arsye e cila forcon bindjen për proces jo objektiv të paragjykuar, lidhet me përmbajtjen e arsyetimit në Vendimet 108 dhe 109 të datës 02.08.2019 për ndalimin e kandidaturës sime për anëtare të Gjykatës Kushtetuese.

Këto vendime mbështeten vetëm në gjykimet e ILDKPKI të konsideruara gjetje edhe nga ana e KED, edhe pse shumica e tyre është kundërshtuar me prova nga ana ime, KED nëpërmjet vendimarrjes së saj nuk i ka konsideruar, duke mos marrë në analizë provat e paraqitura nga unë në këtë proces.

ILDKPKI ka kryer hetimin e pasurisë time në kushtet e Ligjit 84/2016 “PËR RIVLERËSIMIN KALIMTAR TË GJYQOTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”. Lidhur me këtë fakt, më lejoni t’ju kujtoj se unë jam një subjekt që deklaroj për herë të parë pranë këtij organi (ILDKPKI), fakt i cili duhet të ishte mbajtur parasysht nga ILDKPKI por edhe nga KED. Në analizën e gjetjeve të ILDKPKI nuk mund të konsiderohem subjekt rivlerësimi në kuptimin e drejtëpërdrejtë të ligjit 84/2016, sepse pasuria ime vlerësohet për herë të parë dhe ky vlerësim do të kryhet mbi pasuritë ekzistuese dhe burimin e tyre dhe jo mbi faktet juridike që ato përfaqësojnë. Nisur nga teoria e së drejtës civile faktet i kemi disa llojesh, KED nuk ka dhënë një argumentim të qartë se cilës kategorie faktesh juridike i referohet në Vendimet nr 108 dhe 109 të datës 02.08.2019, për ndalimin e kandidimit tim për pozicionin Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

Gjithashtu, duhej që ILDKPKI duke më konsideruar subjekt rivlerësimi duhej të shprehej sipas detyrimit të ligjit 84/2016 “PËR RIVLERËSIMIN KALIMTAR TË GJYQOTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”. Në Nenin 33, pika 5 “Procedura e vlerësimit të pasurisë” parashikohet se:

“...Në përfundimin të kontrollit, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, sipas rastit, konstaton se:

a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konflikti interesi;

b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;

c) është kryer fshehje e pasurisë;

ç) është kryer deklarim i rremë;

d) subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit....”.

Unë vlerësoj se kur KED konstatoi se konkluzioni i kontrollit të pasurisë time i nxjerrë nga ILDKPKI ishte ndryshe nga sa parashikonte Neni 33 i Ligjit 84/2016, për të pasur një panoramë të qartë të situatës në lidhje me gjykimet e ILDKPKI dhe kundërshtimeve të kandidatit, duhet që ta kishte kthyer çështjen për një hetim të thelluar pranë këtij organi me qëllim qartësimin e të gjitha çështjeve që për KED përbënin paqartësi dhe për të cilat caktoi ekspert.

Gjetjet e ILDKPKI, kanë qënë vetëm gjykime dhe vlerësime të pabazuara. I gjithë relacioni i ILDKPKI, nuk ka pasur asnjë analizë financiare nga konkluzioni i së cilës të evidentoheshin gjetjet apo të dilnin pikëpyetje mbi burimin e të ardhurave. Të gjitha “gjetjet”, në fakt janë gjykime bazuar në hipoteza.

Për sa më sipër ndryshe nga KED unë mendoj se ILDKPKI, nuk ka kryer një hetim të thelluar. Për këtë arsye unë kam evidentuar dhe provuar të gjitha gjykimet e ashtëquajtura gjetje në observacionin e dërguar Këshillit por edhe vetë ILDKPKI në Dt 06.06.2019.

Dua t’ju sjell në vëmëndje së procedura e ndjekur nga ILDKPKI për verifikimin e pasurisë time në lidhje me mua nuk është një procedurë e plotë.

Në këto kushte, referuar këtyre parashtrimeve si më sipër, dhe në kushtet kur KED, aktualisht është në një proces brenda të cilit po verifikon me përparësi edhe një herë provat e administruara përgjatë hetimit të tij, prova të cilat janë të njëjta dhe duke u nisur nga vendimarrja e parë mendoj që përfundimi do të jetë i njëjtë, si dhe për evituar konfliktin e interesit në këtë proces është e nevojshme që KED :

Së pari, të marrë një vendim në lidhje me gjëndjen e konfliktit të saj të interesit në procesin e verifikimit mbi kandidaturën time;

Së dyti, përpara se të shprehet me një vendim përfundimtar në lidhje me lejimin ose ndalimin e kandidaturës time për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, me qëllim dhënien e një vendimi të paanshëm dhe të bazuar mbi prova dhe fakte, si dhe kryerjen e një hetimi të plotë dhe të thelluar në lidhje me kontrollin e pasurisë time, KED duhet të kërkojë edhe një herë një vlerësim të thelluar pranë ILDKPKI, e cila duhet të bëjë një hetim të plotë, të të gjithë provave që do të administrohen për pasuritë objekt kontrolli, burimet e krijimit të pasurive, subjektet që kanë kontribuar në krijimin e tyre, transaksionet e ligjshme financiare mbi këto pasuri.

ME RESPEKT

PROF.DR. ZHAKLINA PETO

KERKESE

Zhaklina Peto <zhaklinpeto@gmail.com>

Mon 9/9/2019 11:01 AM

To: Keshilli 2 <keshilli2@ked.gov.al>;

 1 attachment

KËRKESE ZHAKLINA PETO.doc;

Pershendetje!

Te nderuar anetare te KED!

Bashkelidhur ketij emaili po ju paraqes nje kerkese e cila dua te trajtohet ne rendin e dites ne mbledhjen e sotme.

Me Respekte dhe Konsiderate
Zhaklina Peto